



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
DREJTORIA E RREGULLIMIT TË GAZIT NATYROR**

Nr 994 Prot.,

Tiranë, më 27.03.2026

**PLANI VJETOR I VEPRIMTARISË SË DREJTORISË SË RREGULLIMIT TË GAZIT
NATYROR PËR PERIUdhËN MARS-DHJETOR 2026**

Drejtuar: Kryetarit të ERE
Z. Petrit AHMETI

Bordit të ERE

Për dijeni: Sekretarit të Përgjithshëm
Z. Elton B. Radheshi

Këshilltarit të Bordit
Znj. Eva HYNA

Në zbatim të parashikimeve të pikës 2 të nenit 12 dhe nenit 27, të Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e ERE, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 199, datë 27.11.2020, si dhe mbështetur në Vendimin e Bordit të ERE nr. 21, datë 27.01.2026, "Mbi miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së ERE, paraqesim për shqyrtim dhe miratim plani vjetor i veprimtarisë së Drejtorisë së Rregullimit të Gazit Natyror për periudhën mars-dhjetor 2026.

Në vijim të planit vjetor të Drejtorisë së Gazit Natyror, regjistruar me nr. 3037 prot, datë 12.12.2025 dhe në kuadër të rishikimit të fushës së përgjegjësisë dhe detyrave të Drejtorisë së Rregullimit të Gazit Natyror, po paraqesim planin e punës për periudhën e mbetur mars-dhjetor 2026.

Procedurat dhe praktikat që do jenë në vazhdim për vitin 2026:

- Do jetë në vazhdim praktika pas marrjes se vendimit nga bordit nr. 272 datë 10.12.2024 " Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, "Mbi certifikimin e shoqërisë "Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror ALBGAZ" sh.a., i ndryshuar, ku u miratua: "Pika 5.2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, i ndryshuar, bëhet si vijon: 5.2 Brenda datës 31.12.2025 shoqëria "ALBGAZ" sh.a. duhet të depozitojë në ERE realizimin e ndryshimeve në nenin 11 dhe nenin 46, pika 10, të ligjit "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Financave."
- Njohja dhe përgatitja e draftit të informacionit sipas kërkesës dërguar nga Zyrtari I perputhsmerise me shkresën protokolluar ne ERE me Nr. 371/3 date 09.03.2026 , me

subjekt:Dorezimi i Raportit Vjetor te Perputhshmerise se Shoqerise ALBGAZ Sh.a (Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror), per vitin 2025

- Do jetë në vazhdim praktika pas marrjes se vendimit nga bordit në mbledhjen e datës 12.12.2025 "Mbi shtyrjen e vendimarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë ALBGAZ sh.a. për miratimin e planit 10-vjeçar të investimeve.
- Do jetë në vazhdim praktika pas marrjes se vendimit nga bordit në mbledhjen e datës 12.12.2025 për lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a.”, për vitin 2026.
- Do jetë në vazhdim rregullimi dhe shqipërimi pas ndryshimeve në “Kodin e Rrjetit TAP”, propozuar nga Trans Adriatic Pipeline (TAP) AG më 12 maj 2025 dhe më 8 tetor 2025, bashkëngjitur me Shtojca A&B".
- Do jetë në vazhdim praktika lidhur me përditësimi i rregjistrit dhe pregatitja e folderva dixhitale me vendimet e bordit te ERE, që kanë lidhje me Gazi Natyror.
- Gjatë këtij viti parashikojmë të vijojë puna, në bashkëpunim me strukturat kombëtare dhe ndërkombëtare, palët e interesit, lidhur me aspektet rregullatore për përmirësimet e politikave të ardhshme që përshpejtojnë implementim të reformës bazuar në zhvillimet e fundit për sektorin e gazit natyror dhe që ka të bëjë me prioritetin e vendosur nga BE që është, zhvillimi i hidrogjenit të rinovueshëm. Strategjia REPowerEU e vitit 2022 përcaktoi qëllimin e prodhimit të 10 milionë tonëve dhe importimit të 10 milionë tonëve deri në vitin 2030. Deri në vitin 2050, hidrogjeni i rinovueshëm do të mbulojë rreth 10% të nevojave të BE-së për energji, duke dekarbonizuar ndjeshëm proceset industriale që kërkojnë shumë energji dhe sektorin e transportit. Hidrogjeni qëndron si një komponent kyç në strategjinë e BE-së për tranzicionin energjetik, emetimet zero dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- Do jetë në vazhdim praktika për pregatitjen e rregullores dhe licencave tip për të licensuarit që dojnë të zhvillojnë aktivitetin e operimit në impiantet e GNL-së dhe/ose GNK-së, me permasa te vogla.(license importi shperndarje dhe magazinim te GNL dhe GNK me permasa te vogla.
- Do jetë në vazhdim praktika për pregatitje e relacionit sipas kerkeses dërguar nga TAP AG me shkresën datë 29.01.2026, me subjekt:kërkesë për ndryshim në rregulloren për lidhjet e reja, miratuar me Vendimin Nr. 176, datë 14.11.2019 të ERE-s.
- Pregatitja e informacionit per bord në lidhje me ndryshimet në anëtarësinë e bordit drejtues/ këshilli mbikqyrës, të TAP AG, konfidencial.

Drejtoria e Gazit Natyror

Drejtor: **Gerti Bitri**

